



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/89 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02

Data/Datun/Date 26 / 01 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenit 51 paragrafi 51.2 dhe nenit 73, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34, 35, 36 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.1.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

- Me këtë vendim, **formohet** komisioni përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, në këtë përbërje:
 - 1.1. **Qazim Cana**, anëtar i Kuvendit - LDK;
 - 1.2. **Zana Qanta**, anëtare e Kuvendit - LVV;
 - 1.3. **Behlul Krasniqi**, anëtar i Kuvendit - PDK;
 - 1.4. **Afrim Oruqi**, anëtar i ekzekutivit;
 - 1.5. **Lulzim Krasniqi**, anëtar i shoqërisë civile.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e komisionit.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 89/26
Më datë:26.1.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit